



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALI

Nr. 02/ 207

Datë: 05.04.2023

Në bazë të neneve 13 dhe 58, paragrafi 1 shkronja (a) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 40, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, nenit 68, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina, nenit 9, paragrafi 1 i Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe në pajtim me paragrafin 3.1 të nenit 124 si dhe neneve 125, 126 dhe 127, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave kundër aktvendimeve të inspektorëve në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike.
2. Komisioni sipas pikës 1 të Vendimit themelohet në këtë përbërje:
 1. Sami Jonuzi - kryetar,
 2. Xhemshir Shabani - anëtar,
 3. Bajram Gashi - anëtar,
 4. Fatmir Rexhepi - anëtar,
 5. Armend Imeri - anëtar,
3. Komisioni do të veprojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi dhe detyrë e tij është shqyrtimi i ankesave për palët e pakënaqura me vendimet e inspektorëve në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Iu dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Arkivit

Kryetari i Komunës
Qemajl Aliu